



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1050/1 Prot.

Tiranë, më 10/01/2024

VENDIM

Nr. 4, DATË 10/01/2024

MBI

**“MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN MËSIMORE TË CIKLIT TË PARË DHE RREGULLOREN MËSIMORE TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika 1, gërma (d), të Statutit të Universitetit të Arteve, neni 24, pika 1, gërma (h), të Vendimit të Senatit Akademik Nr. 16, datë 07.10.2021 “Mbi miratimin e rregullores mësimore të ciklit të parë të studimeve Bachelor në Universitetin e Arteve”, të Vendimit të Senatit Akademik Nr. 17, datë 07.10.2021 “Mbi miratimin e rregullores mësimore të ciklit të dytë të studimeve Master në Universitetin e Arteve”, si dhe mbështetur në shkresën Nr. 1050 Prot., datë 20.11.2023 të Dekanit të FAB me lëndë “Rregulime mbi të drejtën e përmirësimit të notës nga studenti” (bashkëlidhur), pas shqyrtimit dhe diskutimeve, Senati Akademik i UART,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren mësimore të ciklit të parë të studimeve Bachelor dhe në Rregulloren mësimore të ciklit të dytë të studimeve Master në Universitetin e Arteve.

Ndryshimet do të paraqiten me gërma italiane dhe do të jenë të nënvizuara, si më poshtë vijon:

- Neni 23, pika 4 e Rregullores mësimore të ciklit të parë të studimeve Bachelor, shtohen dy fjali pas fjalisë ekzistuese:  
“Kur studenti kërkon të përmirësojë vlerësimin e marrë në provim, si notë përfundimtare mbetet vlerësimi i bërë mbas kërkesës për përmirësim. Kur studenti ka bërë kërkesë për përmirësim note, por nuk paraqitet në provim, mbetet në fuqi nota e mëparshme. Ky parashikim zbatohet me analogji edhe për rregulloret e tjera mësimore.”
- Neni 23, pika 5 e Rregullores mësimore të ciklit të dytë të studimeve Master, ndryshon përmbajtjen në:  
“Kur studenti kërkon të përmirësojë vlerësimin e marrë në provim, si notë përfundimtare mbetet vlerësimi i bërë mbas kërkesës për përmirësim. Kur studenti ka bërë kërkesë për

përmirësim note, por nuk paraqitet në provim, mbetet në fuqi nota e mëparshme. Ky parashikim zbatohet me analogji edhe për rregulloret e tjera mësimore”.

- Neni 23, pika 5 e Rregullores së ciklit të dytë të studimeve Master, ndryshon numrin rendor në 6 (gjashtë), por ruan të njejtën përmbajtje:  
“Në rastin e organizimit të moduleve të përbërë ku marrin pjesë më shumë se një disiplinë, ku vlerësimi realizohet nëpërmjet provimeve të integruara, ose shlyerjes së modulit me pjesë, përmirësimi i notës bëhet për të gjithë modulin”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Asoc. Dr. Artan IBËRSHIMI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Zamir KOKONOZI

Prof. Asoc. Genci FUGA

Erlind FUSHA (Student FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA  
DEKANI

Nr. 1050 Prot.

Tiranë, më 20/11/2023

Lënda: Rregullime mbi të drejtën e përmirësimit të notës nga studenti

REKTORIT / KRYETARIT TË SENATIT AKADEMIK  
Prof. Kastriot ÇAUSHI

Për dijëni: ZËVENDËSREKTORIT PËR ANËN MËSIMORE  
Prof. Dr. Erald BAKALLI

Të nderuar,

Duke marrë shkasë nga rastet dhe përvoja me disa studentë pranë Fakultetit të Arteve të Bukura, ju shkruaj për të propozuar një ndryshim në Rregulloren mësimore të ciklit të parë të studimeve Bachelor dhe në Rregulloren mësimore të ciklit të dytë të studimeve Master në Universitetin e Arteve, miratuar përkatësisht me Vendim të Senatit Akademik Nr. 16 dhe Nr. 17, datë 07.10.2021.

Neni 23, pika 4 e Rregullores së ciklit të parë të studimeve Bachelor parashikon se “Kur studenti kërkon të përmirësojë vlerësimin e marrë në provim, si notë përfundimtare mbetet vlerësimi i bërë mbas kërkesës për përmirësim”, për të cilin jemi plotësisht dakord. Mirëpo, në këtë nen nuk bëhet një rregullim i rasteve kur studenti nuk paraqitet ditën e provimit për përmirësim. Për këtë arsye, propozojmë që në pikën 4 të kësaj Rregulloreje të shtohet ky parashikim dhe kjo pikë të marrë trajtë përfundimtare në:

**“Kur studenti kërkon të përmirësojë vlerësimin e marrë në provim, si notë përfundimtare mbetet vlerësimi i bërë mbas kërkesës për përmirësim. Kur studenti ka bërë kërkesë për përmirësim note, por nuk paraqitet në provim, mbetet në fuqi nota e mëparshme. Ky parashikim zbatohet me analogji edhe për rregulloret e tjera mësimore.”**

Ndërkohë, propozojmë që në Rregulloren e ciklit të dytë të studimeve Master, teksti i pikës 5 të nenit 23, të ndryshojë përmbajtjen në: ***“Kur studenti kërkon të përmirësojë vlerësimin e marrë në provim, si notë përfundimtare mbetet vlerësimi i bërë mbas kërkesës për përmirësim. Kur studenti ka bërë kërkesë për përmirësim note, por nuk paraqitet në provim, mbetet në fuqi nota e mëparshme. Ky parashikim zbatohet me analogji edhe për rregulloret e tjera mësimore”***.

Pika 5 e nenit 23 të Rregullores së Ciklit të dytë të studimeve Master me përmbajtje ***“Në rastin e organizimit të moduleve të përbërë ku marrin pjesë më shumë se një disiplinë, ku vlerësimi realizohet nëpërmjet provimeve të integruara, ose shlyerjes së modulit me pjesë, përmirësimi i notës bëhet për të gjithë modulit”***, të mbetet e pandryshuar në tekst, por të ndryshojë numri rendor në 6 (gjashtë).

Në përmbyllje, kërkoj të konsideroni paraqitjen e këtij propozimi pranë Senatit Akademik të Universitetit të Arteve dhe amendimin e 2 (dy) rregulloreve përkatëse.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Prof. Artan PEQINI

  
DEKANI  
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURIA



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 16, datë 07.10.2021

MBI

**"MIRATIMIN E RREGULLORES MËSIMORE TË CIKLIT TË PARË TË  
STUDIMEVE BACHELOR NË UNIVERSITETIN E ARTEVE"**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, për "Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Urdhrin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 319, datë 13.09.2021 "Për miratimin e Statutit të Universitetit të Arteve", pasi diskutoi rreth propozimit të rregullores mesimore të ciklit të parë të studimeve Bachelor në UAR, përcjellë nga grupi i punës i ngjitur me në Urdhrin e Rektorit me nr. 145, datë 14.09.2021, me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores mesimore të ciklit të parë të studimeve Bachelor në Universitetin e Arteve.
2. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Prof. Kastriot CAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimír MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

firmat e anëtarëve të komisionit.

7. Në rast të gabimeve në plotësimin e fletës së provimit, hartohet një procesverbal me firmat e anëtarëve të komisionit të provimit, përgjegjësit të njësisë bazë dhe Zv. Dekanit. Dekani merr vendimin për asgjësimin e fletës së provimit të hartuar gabim dhe lëshimin e një flete të re provimi.

#### Neni 22

##### Kushtet e kalimit në vitin pasardhës

1. Viti Akademik mbyllet në përfundim të sezonit të vjeshtës.
2. Për të gjitha programet e studimit, studenti i vitit të parë kalon në vitin e dytë nëse ai ka marrë jo më pak se 48 kredite të vitit të parë, sipas përcaktimit dhe në varësi të rregullores së fakultetit përkatës.
3. Studenti i vitit të dytë kalon në vitin e tretë, nëse ai ka marrë jo më pak se 96 kredite.
4. Studenti shpallet përsëritës i vitit kur:
  - a) Nuk plotëson kushtet e caktuara pikat 2-3 të këtij neni.
  - b) Përfashtohet një vit nga shkolla për shkelje të rregullave të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore, në Statutin e UART si dhe rregulloreve përkatëse.
5. Studenti përsëritës ka këto të drejta e detyrime:
  - a) I njihen të gjitha detyrimet e shlyera kur programet e lëndëve përkatëse janë të pranueshme për vitin në vazhdim.
  - b) Mund të frekuentojë lëndët për të cilat është vlerësuar mbetës me 25% të mungesave dhe është i detyruar të frekuentojë lëndët, për të cilat ka detyrim frekuentimin.
  - c) Duhet të shlyejë detyrimet e reja që lindin për shkak të ndryshimit të planit mësimor dhe programeve mësimore.
  - d) Të ripaguajë tarifën vjetore të shkollimit që i përket vitit akademik, në të cilin do të rifillojë studimet.

#### Neni 23

##### Përmirësimi i notave

1. Studenti ka të drejtë të kërkojë të përmirësojë notën. Një veprim i tillë lejohet kur nota që kërkon të përmirësojë studenti është e një detyrimi të vitit që ai sapo ka mbyllur. Studenti ka të drejtë të përmirësojë deri në 3 (tre) nota gjatë tre viteve të ciklit të parë të studimit. Ai nuk ka të drejtë të përmirësojë notën e lëndës speciale.
2. Për përmirësimin e notës, studentët e vitit të parë dhe vitit të dytë kanë të drejtë të hyjnë në riprovim vetëm 1 (një) herë dhe vetëm në sezonin e vjeshtës. Studentët e kursit të tretë kanë të drejtë të hyjnë në riprovim vetëm në sezonin e verës dy javë para mbrojtjes së diplomës.
3. Kërkesa për përmirësim note i paraqitet Përgjegjësit të Njesisë Bazë jo më vonë se një javë pas përfundimit të provimit përkatës. Në bazë të vendimit që merr përgjegjësi i departamentit në zbatim të rregulloreve të UART, sekretaria mësimore kryen veprimet përkatëse.
4. Kur studentit kërkon të përmirësojë vlerësimin e marrë në provim, si notë përfundimtare mbetet vlerësimi i bërë mbas kërkesës për përmirësim.
5. Në rastin e organizimit të moduleve të përbërë ku marrin pjesë më shumë se një disiplinë, ku vlerësimi realizohet nëpërmjet provimeve të integruara, ose shlyerjes së modulit me pjesë, përmirësimi i notës bëhet për të gjithë modulit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 17, datë 07.10.2021

MBI

**“MIRATIMIN E RREGULLORES MËSIMORE TË CIKLIT TË DYTË TË  
STUDIMEVE MASTER NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Urdhrin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 319, datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të Universitetit të Arteve”, pasi diskutoi rreth propozimit të rregullores mësimore të ciklit të dytë të studimeve Master në UART, përcjellë nga grupi i punës i ngritur me në Urdhrin e Rektorit me nr. 146, datë 14.09.2021, me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores mësimore të ciklit të dytë të studimeve Master në Universitetin e Arteve.
2. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

e anëtareve të komisionit të provimit, përgjegjësit të njësive bazë dhe Zv. Dekanit. Dekani merr vendimin për asgjësimin e fletës së provimit të hartuar gabim dhe lëshimin e një flete të re provimi.

#### Neni 22

##### Kushtet e kalimit në vitin pasardhës

1. Viti Akademik mbyllet në përfundim të sezonit të vjeshtës.
2. Për të gjitha programet e studimit, studenti i vitit të parë kalon në vitin e dytë nëse ai ka marrë jo më pak se 48 kredite të vitit të parë, sipas përcaktimit dhe në varësi të rregullores së fakultetit përkatës.
3. Studenti shpallet përsëritës i vitit kur:
  - a) Nuk plotëson kushtet e caktuara pikat 2-3 të këtij neni.
  - b) Përfshihet një vit nga shkolla për shkelje të rregullave të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore, në Statutin e UART si dhe rregulloreve përkatëse.
4. Studenti përsëritës ka këto të drejta e detyrime:
  - a) I njihen të gjitha detyrimet e shlyera kur programet e lëndëve përkatëse janë të pranueshme për vitin në vazhdim.
  - b) Duhet të frekuentoje lëndët për të cilat është vlerësuar mbetës me 25% të mungesave dhe është i detyruar të frekuentoje lëndët, për të cilat ka detyrim frekuentimin.
  - c) Duhet të shlyejë detyrimet e reja që lindin për shkak të ndryshimit të planit mësimor dhe programeve mësimore.
  - d) Të ri paguajë tarifën vjetore të shkollimit që i përket vitit akademik, në të cilin do të rifillojë studimet.

#### Neni 23

##### Përmirësimi i notave

1. Studenti ka të drejtë të kërkojë të përmirësojë notën. Një veprim i tillë lejohet kur nota që kërkon të përmirësojë studenti është e një detyrimi të vitit që ai sapo ka mbyllur. Studenti ka të drejtë të përmirësojë deri në 2(dy) nota gjatë dy viteve të ciklit të dytë të studimit. Ai nuk ka të drejtë të përmirësojë notën e lëndës speciale.
2. Për përmirësimin e notës, studentët e vitit të parë kanë të drejtë të hyjnë në riprovim vetëm 1(një) herë në sezonin e vjeshtës. Studentët e vitit të dytë kanë të drejtë të hyjnë në riprovim vetëm në sezonin e verës dy javë para mbrojtjes së diplomës.
3. Kërkesa për përmirësim note i paraqitet Përgjegjësit të njësive Bazë jo më vonë se një javë pas përfundimit të sezonit. Në bazë të vendimit që merr përgjegjësi i departamentit, sekretaria mësimore kryen veprimet përkatëse.
4. Studenti mund të përmirësojë vetëm vlerësimin e marrë në provim, i cili i bashkëngjitet vlerësimit të marrë në elementët e tjerë të lëndës përgjatë vitit shkollor.
5. Në rastin e organizimit të moduleve të përbërë ku marrin pjesë më shumë se një disiplinë, ku vlerësimi realizohet nëpërmjet provimeve të integruara, ose shlyerjes së modulit me pjesë, përmirësimi i notës bëhet për të gjithë modulën.